



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA

MINISTËR I SHTETIT PËR RININË DHE FËMIJËT

Nr. 1184 Prot.

Tiranë, më 9 . 3 . 2023

**TERMAT E REFERENCËS
PËR “APLIKIM SI ANËTAR EKSPERT NGA
SHOQËRIA CIVILE NË KOMISIONIN E VLERËSIMIT TË
PROJEKTPROPOZIMEVE TË KANDIDATËVE PËR FONDET GRANT PËR
RININË”**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të Vendimit nr.566, datë 29.07.2022 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të përzgjedhjes së organizatave rinore dhe organizatave për të rinjtë, që përfitojnë financime nga fondet grant nga buxheti i shtetit, të dedikuara për rininë”,

Në zbatim të Ligjit Nr. 75/2019 “Për Rininë” dhe vendimit nr.566, datë 29.07.2022 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave të përzgjedhjes së organizatave rinore dhe organizatave për të rinjtë, që përfitojnë financime nga fondet grant nga buxheti i shtetit, të dedikuara për rininë”, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët shpall thirrjen për aplikim si anëtar ekspert nga shoqëria civile në Komisionin e Vlerësimit të projektpropozimeve.

Qëllimi:

Pjesëmarrja në Komisionin e Vlerësimit e (dy) anëtarëve ekspert nga shoqëria civile për shqyrtimin dhe vlerësimin e projektpropozimeve të përgatitura nga kandidatët në thirrjet konkurruese të shpallura nga Agjencia Kombëtare e Rinisë për vitin 2023.

Në përputhje me parashikimet e projektit rajonal “Fuqizimi i rolit të të rinjve për promovimin e mirëkuptimit reciprok, narrativës konstruktive, respektit për diversitetin dhe rritjes së besimit, në Shqipëri, Kosovë, Bosnje dhe Hercegovinë, Maqedoninë e Veriut dhe Serbi” nënshkruar nga Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët dhe Koordinatori i Përhershëm i OKB-së në Shqipëri në prill 2022, UNDP Albania mbështet MSHRF dhe AKR-në duke siguruar ekspertizë teknike në procesin e përzgjedhjes dhe kontraktimin e (dy) anëtarëve ekspert nga shoqëria civile në Komisionin e Vlerësimit të projektpropozimeve, duke rritur nivelin e transparencës, pjesëmarrjes dhe besueshmërinë e procesit.

Procesi i përzgjedhjes së aplikanteve:

Përzgjedhja e anëtarëve ekspert nga shoqëria civile në Komisionin e Vlerësimit të projektpropozimeve do të bazohet në një proces të hapur konkurrimi dhe zhvillohet në dy faza:

Në fazën e parë, UNDP Albania do të zhvilloj procesin e vlerësimit të aplikimeve mbi bazë të vlerësimit të kritereve teknike (70%) dhe propozimit financiar (30%) të aplikantëve.

Në fazën e dytë, Ministri i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët do përzgjedhë dy anëtarët ekspert dhe dy anëtarët rezervë, në rast krijimi të vakancës, nga shoqëria civile në Komisionin e Vlerësimit të projekt-propozimeve.

Kriteret e aplikimit:

Anëtarë ekspert nga shoqëria civile në Komisionin e Vlerësimit të projekt-propozimeve, duhet të plotësojë kushtet mëposhtme:

- Të ketë mbaruar studimet universitare “master” për drejtësi, administrim publik, shkencë ekonomike apo shkencë shoqërore;
- Të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- Të ketë mbi 10 (dhjetë) vjet përvojë pune;
- Të ketë përvojë të mëparshme në vlerësimin e projektpropozimeve të organizatave të shoqërisë civile në thirrje konkurrese për financim;
- Të ketë përvojë në përgatitjen, zbatimin, monitorimin dhe/ose vlerësimin e projektpropozimeve të financuara me fonde publike;
- Të ketë njohuri në fushën e politikave dhe çështjeve rinore;

Procesi i aplikimit

Kandidatët e interesuar duhet të ndjekin procedurat e aplikimit në faqen e internetit, si vijon:

https://procurement-notices.undp.org/view_negotiation.cfm?nego_id=2778&gl=1*1yy6c1s*_ga*MTQxNTY2NTQwMi4xNjc3NTkzMDE2*_ga_TGHFVBO9DR*MTY3NzY2NzY1OS4yLjE0MTY3NzY2NzY4Ni4zMy4wLjA

Afati i aplikimit:

Afati përfundimtar i dorëzimit të aplikimit është data 13 mars 2023.

Periudha e zbatimit të detyrave:

Prill – Qershor 2023

Ekspertët e përzgjedhur do të paguhën nga UNDP Albania sipas rregullave të brendshme financiare të këtij institucioni.

Informacion shtesë:

Dy anëtarët ekspert nga shoqëria civile në Komisionin e Vlerësimit të projektpropozimeve do të kontraktohen dhe paguhen nga UNDP Albania.

MINISTER

BORA MUZHAQI

